

VENDIM
Nr. 83, datë 31.1.2020

**PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE NDROQ, BASHKIA TIRANË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË
TIRANË SI NJËSI ZBATUESE**

(ndryshuar me VKM nr. 198, datë 6.4.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjeve “iii” e “iv”, të shkronjës “b”, të nenit 13 dhe të pikës 3, të nenit 16, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, të zonës 1, Njësia Administrative Ndroq, Bashkia Tiranë, zonë e re për zhvillim.

2. Caktimin e Bashkisë Tiranë për këtë zonë, si njësi zbatuese, për:

a) ndërtimin e banesave të reja ose të ndërtesave publike të dëmtuara;

b) ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike e kritike;

c) realizimin e ndërtimeve në këtë zonë;

ç) çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të kësaj zone.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

(ndryshuar harta dhe koordinatat me VKM nr. 198, datë 6.4.2022)

